



KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA
REGIONALNA KOMPANIJA ZA OTPADKE
"EKOREGJIONI" SH. A. -D.D. PRIZREN

Email:krm_ecoregjioni@yahoo.com

Numër:

Prizren, 15.03.2016

Kompania Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" SH.A. me seli në Prizren, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv, në bazë të nevojës së paraqitur në Njesine Operative Rahovec, ne sektorin e pastrimit të rrugëve, në përputhje me Ligjin e Punës, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Brendshme, konform aktvendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 15.03.2016, shpall këtë:

K O N K U R S

Për vend të lirë pune

Në Njësine Operative Rahovec

Vendi i punës Rahovec,
Vende të lira 5.

Titulli i vendit të punës:

- ***Inkasant,***
- ***Punëtor fizik.***

Detyrat e dhëna të punësuarit- përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës pozita inkasant përmban si vijon:

- Bën inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materialisht,
- Bën zbulimin- regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar shërbimin e faturimit.
- Të gjitha paratë e inkasuara i dorëzon brenda dite, në bankën më të afërt apo sipas nevojës në arkën kryesore të kompanisë,
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga punëdhënësi sipas nevojës të procesit të punës në interes të ndërmartjes.
- Raporton të faturisti financiar dhe menaxheri i njësisë.

Detyrat e dhëna të punësuarit- përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës pozita punëtor fizik përmban si vijon

- Te jete i afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat sipas kontratës se punës,
- Përmbush te gjitha detyrat qe kane te bëjnë me standardet publike sanitare, pastrimin e rrugëve, trotuareve, shkarkimin e mbeturinave dhe punët ne sferën e riciklimit,
- Përmbush te gjitha detyrat dhe pune te tjera qe kërkohen përbrenda njësisë për shërbimet ditore,
- Përgjegjës për mirëmbajtje te rregullt te mjeteve dhe te uniformes se punës,
- Te raportoj te mbikëqyrësi, përgjegjësi operativ dhe menaxheri i njësisë.

Nen përgjegjësin e : Mbikëqyrësit (kryepunëtorit) / Menaxherit te Njësisë Operative/Menaxherit

Operativ Regjional/ Kryeshefit Ekzekutiv,

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopja e certifikatës se lindjes,
- Certifikatën shëndetësore,
- Certifikata për të kaluarën kriminale, nga Gjykata Themelore dhe nga Policia e Kosovës.
- Kopje e diplomës ose certifikatat e shkollës mesme për pozitën inkasant, ndërsa për punëtor fizik mjafton certifikata e shkollës fillore.
- Kërkesa me numër të telefonit bashke me dëshmi tjera qe tregojnë për përvojë pune.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Dokumentacioni jo i plotë nuk do të merret në konsideratë.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret, do të njoftohen me telefon për vendin dhe kohën e intervistës.

Dokumentacioni i kërkuar bashke me kërkesën (aplikacionin) plotësohet dhe dorëzohet në zyrat e Ekoregjionit, adresën KRM “Ekoregjioni” SH.A. Rr. Kukesit nr. 10 në Prizren- **kopjet e dorëzuara nuk kthehen.**